



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:044350
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05479064

C.nr.2022:044351

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtaren Kreshnike Zymberi Beqiri, me bashkëpunëtoren profesionale Vjosa Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. Z. të cilin e përfaqëson nëna F.R. nga Ferizaj, të cilët me autorizim i përfaqëson av.Liman Musa nga Ferizaj, kundër të paditurës KS "P." me seli në Prishtinë, për çështjen objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material, jashtë seance me datën 18 mars 2024, morri këtë;

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.2022:044351, e paditësit E.Z. të cilin e përfaqëson nëna F.R. nga ..., kundër të paditurës KS "P." me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen juridike kompensim i dëmit material dhe jo material.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, ka ushtruar padi më datë 07.03.2022, kundër të paditurës lidhur me çështjen juridike kompensim i dëmit material dhe jo material.

Gjykata, me qëllim të shqyrtimit të kësaj çështje, me datën 08.03.2023 ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, për të cilën palët ndërgjyqëse janë ftuar me ftesa te rregullta.

Me datën 08.02.2024 në gjykatë nga i autorizuari i paditësit, është dorëzuar parashtrësja me anë të së cilës, paditësi e ka bërë tërheqjen e padisë pasi që me palën e paditur ka arritur marrëveshje jashtë gjyqësore.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387 par.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet ka vendosur konform nenit 456 par.1 lidhur me 450 të LPK-së, pasi që asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr. 2022:044351, me datën 18 mars 2024

Gjyqtarja
Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.